



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave

V E N D I M

(PROJEKT)

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2018

PËR

**MIRATIMIN E MASAVE PËR KOSTOT E MENAXHIMIT TË  
INTEGRUAR TË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e masave për llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve, udhëzuesit dhe modeleve të llogaritjes së tarifave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim dhe shtojcat bashkëlidhur kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
3. Udhëzuesi dhe modelet për llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve do i shërbejë Njësitë të Qeverisjes Vendore, duke u bazuar në numrin e banorëve dhe familjeve, që kanë në territoret e tyre sipas ndarjes administrative.
4. Ngarkohen të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi RAMA**

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN

#### PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR KOSTOT E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i këtij akti është miratimi i masave, për llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve, udhëzuesit dhe modeleve të llogaritjes së tarifave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Ky projektvendim vjen si një detyrim ligjor dhe konkretisht në zbatim të ligjit nr.10463 të vitit 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Neni 20 i këtij ligji përcakton së Këshilli i Ministrave merr masat për miratimin e rregullave që duhet të ndjekin institucionet menaxhuese të mbetjeve.

Me anë të këtij projektvendimi i cili vjen si një detyrim i drejtëpërdrejtë i ligjit, synohet të përmbushet mungesa e kuadrit ligjor dhe nënligjor për trajtimin e çështjeve dhe të marrjes së masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Theksojmë se metodologjia e përlllogaritjes së kostove dhe tarifave, sipas draft VKM së propozuar ka ardhur si rezultat i një pune disa vjeçare i disa institucioneve qëndrore në bashkëpunim dhe me asistencë të Programit për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (DLDP), i financuar nga Qeveria Zvicerane.

Nisur nga situata emergjente që kanë aktualisht Njësitë e Vetqeverisjes Vendore në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në territorin administrativ, si dhe me kërkesat ndër vite të bëra nga vetë këto njësi, shprehim bindjen se në radhë të pare, ky projektvendim do t’ju vijë atyre në ndihmë, për t’i orientuar në lidhje me mënyrat e përlllogaritjes së kostove dhe tarifave, gjatë hartimit të studimeve

të fizibilitetit, për t'i dhënë zgjidhje çështjes së menaxhimit të mbetjeve duke u mbështetur në këtë proces dhe nga qeverisja qendrore.

Procesi i përgatitjes së projektvendimit ka paraprirë dhe ka kaluar në të gjitha fazat teknike të konsolidimit të tij, duke u përmirësuar në raport me praktikën aktuale në bashki, testimet me modele të ndryshme dhe marrjes dhe reflektimit të komenteve nga të gjithë ekspertët e sektorit si në nivel bashkie dhe në nivele të tjera ministrore apo ofrues konsulence.

Çdo përmirësim i modelit ka kaluar në diskutim me bashkitë në nivel të garantimit të shërbimit, pra përcaktimit të formës së organizimit, strukturave zbatuese, vështirësive dhe nevojave të stafëve në zbatim të shërbimit. Testimet kanë treguar se modeli është solid dhe arrin të mundësojë një planifikim të mirë të buxhetit për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor.

I gjithë ky proces ka zgjatur tre vjet dhe më pas është konsoliduar në një model, i hartuar në excel dhe një udhëzuesi i cili u formatua si draft VKM.

Nevoja për këtë model që propozohet me anë të këtij projektvendimi, lidhet me aspekte shumë thelbësore dhe pse nuk është e limituar vetëm në to, si:

-Të kostohet shërbimi në mënyrë të plotë, duke marrë parasysh të gjitha nevojat që ka ai dhe duke zbatuar udhëzimet teknike për mjetet dhe standardet e ofrimit të shërbimit (Bashkitë duke mos pasur një metodë aktuale shpesh herë ose gjithmonë është lënë jashtë vlerësimit, aspekte të ndryshme të shërbimit, si administrimi, mbulimi i shërbimit, kostimit në çdo zë, etj.).

-Modeli bashkëlidhur projektvendimit dhe që është pjesë thelbësore e tij, është ndërtuar për t'i dhënë zgjidhje dhe vlerësim të kostos për të gjitha mbetjet bashkiake. Këto mbetje përfshijnë të gjitha mbetjet që dalin nga shtëpitë, bizneset dhe institucionet. Këto mbetje janë detyrim i bashkisë për menaxhim.

-Në këtë VKM dhe udhëzues nuk përfshihen mbetjet jo bashkiake dhe të rrezikshme, për të cilat zbatohen ligje dhe protokolle të tjera, si p.sh. mbetjet spitalore, të cilat menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë e cila angazhon biznesin privat për menaxhimin e tyre dhe nuk kryhet nga Bashkia.

Objektivat që synon ky projektvendim është mundësimi dhe orientimi i Njësive të Qeverisjes Vendore në përgatitjen e saktë të kostove të menaxhimit të mbetjeve, si dhe të adresojë bashkitë për formën dhe mënyrën si bëhet

buxhetimi, që të jetë më i kontrolluar, duke siguruar transparencë për qytetarët dhe mënyrën si llogariten tarifat e mbetjeve.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Projektvendimi është në përputhje të plotë me programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2018.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i këtij projektakti, i cili rrjedh si detyrim i nenit 20 të ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, do të plotësojë kuadrin nënligjor për menaxhimin e mbetjeve.

Ky projektvendim ka si qëllim:

- Udhëzimin dhe orientimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për përcaktimin e rregullave për identifikimin, analizimin e elementëve përbërës të kostos dhe tarifës së shërbimit të mbetjeve urbane për bërjen e tyre eficiente;
- Qartësimin dhe unifikimin e mënyrës së llogaritjes së kostove dhe vendosjes së tarifave të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve me qëllim transparencën ndaj publikut dhe monitorimin;
- Rregullimin e sistemit të kostimit me qëllim ofrimin e një shërbimi me bazë performance;
- Forcimin e parimit “Ndotësi paguan” nëpërmjet tarifimit të drejtë të gjeneruesve të mbetjeve.

Aktualisht kostoja e shërbimit dhe menaxhimit tarifar të mbetjeve nuk janë të rregulluara me ndonjë akt nënligjor të miratuar nga ndonjë autoritet qendror, siç del nga detyrimi ligjor i sipërpërmendur. Njësitë e Qeverisjes Vendore bazuar në njohuritë dhe kapacitetet e tyre më të mira i përcaktojnë tarifat pa pasur një metodologji orientuese. Modelet e aplikuara për kostimin dhe vendosjen e tarifave janë të ndryshme në njësi vendore të ndryshme, bazuar në norma e

kritere shpesh të trashëguara në dekada dhe kjo në jo pak raste ka sjellë problematika të ndryshme.

Ky projektvendim pas miratimit nga Këshilli i Ministrave do të ndihmojë dhe orientojë Njësitë e Qeverisjes Vendore, në llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Në bazë të nenit 23/10 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Qeverisjes Vendore është përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve, brenda juridiksionit të saj administrativ-territorial, pasi ky është roli dhe funksioni i saj.

Në këtë kontekst, bashkitë përballojnë kostot për përmbushjen e këtij funksioni nga të ardhurat e tyre. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 22, të ligjit 139/2015, në rastet kur Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare. Ky projektvendim do të mundësojë që Njësitë e Qeverisjes Vendore të llogarisin kostot dhe përcaktimin e tarifave, për menaxhimin e integruar të mbetjeve në territorin administrativ të tyre dhe mundësimin e një analize të plotë financiare për përballim të tyre. Nga kjo analizë do të përcaktohet dhe mundësia që do ketë Njësia e Qeverisjes Vendore, për përballimin e kostos dhe shpenzimeve nga buxheti i tyre apo do kërkojnë dhe ndihmën e qeverisjes qendrore për të mundësuar realizimin e këtij shërbimi të detyrueshëm dhe të domosdoshëm publik që është menaxhimi i mbetjeve.

Përgatitja e këtij projektvendimi është paraprirë dhe nga disa procese të tjera të ndërmarrë nga institucionet shtetërore qendrore në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore, ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mbështetur nga agjencitë ndërkombëtare nëpërmjet Programit për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim. Për këtë janë organizuar dhe konferenca kombëtare, ku kanë marrë pjesë të gjitha aktorët e nevojshëm për këtë proces duke përfshirë dhe njësitë zbatuese të qeverisjes vendore duke u fokusuar dhe prezantuar dhe në Udhëzuesin “Metodat e llogaritjes së kostos dhe tarifave në menaxhimin e mbetjeve të ngurta”. Gjithashtu nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është organizuar dhe një trajnim dy ditor në bashkëpunim me ASPA-n (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike), ku janë trajnuar pjesmarrës dhe përfaqësues të njësive vendore për programin teorik dhe praktik të llogaritjes së kostos dhe tarifave për menaxhimin e mbetjeve.

Pra ky projektvendim do finanlizojë këtë proces disa vjeçar të qeverisë Shqiptare dhe do mundësojë zbatimin në praktikë nga NJQV, të llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve në territorin e tyre administrativ.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Gjatë përgatitjes së projektvendimit, është analizuar një gamë e gjerë legjislationesh, ku do të veçonim:

- Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;
- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr.9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;
- VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”.
- Plani Kombëtar për Integrim European (2017-2020)

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE).**

Ky vendim nuk përfron ndonjë direktivë apo rregullore të BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.**

Ky projektvendim është hartuar në katër pika duke pasur parasysh:

- Pika e parë miraton masat për llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve, udhëzuesit dhe modeleve të llogaritjes së tarifave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi, si detyrim ligjor që vjen nga neni 20 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar .
- Shtojcat përcaktojnë orientime dhe udhëzojnë Njësitë e Qeverisjes Vendore që të marrin parasysh kushtet dhe kriteret e ndryshme gjatë

llogaritjes së kostove të menaxhimit dhe përcaktimit të tarifave për menaxhimin e mbetjeve.

Theksojmë se Njësitë e Qeverisjes Vendore janë kompetente për caktimin e kostos dhe tarifave, kompetencë të cilën e kanë të plotë dhe ekskluzive të tyre për të gjithë territorin administrativ që mbulojnë.

- Shtojca 1: Është udhëzues për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- Shtojca 2: Është udhëzues për modelet për llogaritjen dhe vendosjen e tarifave për menaxhimin e mbetjeve.

Projektvendimi udhëzon që për përcaktimin e kostove Njësitë e Qeverisjes Vendore do të qartësojnë elementët e kostimit dhe mënyrën e llogaritjes së tyre në njësitë e kostove duke pasur parasysh:

- Investime kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm)
- Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel)
- Kosto për depozitim (elementët kryesorë)
- Kostot e amortizimit (ri-investimit)
- Kostot administrative

Projektvendimi në rregullat për përcaktimin e tarifave do të paraqesë modele, të cilat bazohen në parimet kryesore të rikuperimit të kostos:

- *Mbulimi i kostos*: menaxhimi i mbetjeve duhet të operohet për të siguruar mbulimin e plotë të kostos, i cili mbulon operimin dhe mirëmbajtjen, kostot administrative dhe të amortizimit.
- *Ndotësi paguan*: gjeneruesi i mbetjes duhet të paguajë për eliminimin e saj në mënyrë sa më proporcionale, në bindje të praktikave të mira, duke nxitur reduktimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin, si dhe duke iu shmangur sa më shumë të jetë e mundur hedhjes së mbetjeve në natyrë.
- *Barazia*: kushtet e ngjashme të gjeneruesve dhe të gjenerimit të mbetjeve duhet të paguajnë mundësisht tarifa të ngjashme.
- *Ekuivalenca*: shuma e tarifave të mbledhura duhet të jetë në përputhje me atë të shpenzimeve (jo nën e as mbi); të ardhurat nuk mund të përdoren për qëllime të tjera (p.sh. rrugë apo ujësjellës).
- *Transparenca*: tarifat duhet të reflektojnë kostot dhe qytetarët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente për kostot dhe llogaritjen e tarifave.
- *Thjeshtësia*: një element shumë i rëndësishëm është përcaktimi i një sistemi të thjeshtë, i cili është i përshtatur në të dhëna të përballueshme dhe i lirë në në koston e zbatimit (llogaritja e faturimit dhe arkëtimit).

- Pika 2 e projektvendimit sqaron se termat e përdorur në shtojcat bashkëlidhur kanë kuptimin sipas përcaktimeve të dhëna në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Pika 3 përcakton se Udhëzuesi dhe modelet për llogaritjen e kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve do i shërbejë Njësive të Qeverisjes Vendore të cilat në përputhje me ligjin për mbetjet dhe ligjin për organizimin e vetqeverisjes vendore, duke u bazuar në numrin e banorëve dhe familjeve, që kanë në territoret e tyre sipas ndarjes administrative përkatëse.
- Pika 4 përcakton se ky vendim do ndiqet dhe zbatohet nga të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të cilët ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

-Njësitë e Qeverisjes Vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.**

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Financave
- Ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë të mbështetur nga agjencitë ndërkombëtare si Helvetas Albania nëpërmjet Programit për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (DLDP).

Projektvendimi u dërgua për komente në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

1. Lidhur me komentet e **Ministrisë së Drejtësisë**, të dërguar me shkresën e fundit nr.3413/1 datë 30.05.2017, sqarojmë se komentet dhe mendimet janë marrë parasysht dhe janë pasqyruar në këtë draft VKM.

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”



Lidhur me pikën e parë të komenteve të MD, shprehemi se projektakti është riformuluar duke përfshirë në draft vetëm çështjet e deleguara nga dispozitat urdhëruese dhe autorizuese të ligjit dhe konkretisht nenit 20 të ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Neni 20 i ligjit përcakton se Këshilli i Ministrave, përcakton me vendim masat për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me këtë projektvendim është propozuar miratimi i masave sipas pikës 1 të projektvendimit.

Pra në këtë këndvështrim, ky projektvendim është rihartuar në përputhje të plotë me delegimin që bën neni 20, tek Këshilli i Ministrave për rregullimin nënligjor të kësaj fushe.

Për sa i takon komentit të dytë, të MD sqarojmë se ky projektvendim nuk përcakton tarifat për shërbim vendor por udhëzon Njësitë e Qeverisjes Vendore për mënyrën e përlllogaritjes së kostos dhe tarifave të shërbimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Janë vetë Njësitë e Qeverisjes Vendore që kanë tagrin e përcaktimit të kostove dhe tarifave duke u bazuar në këtë projektvendim si një busullë për orientim dhe unifikim të metodologjisë së vlerësimit nga të gjitha Njësitë Vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. **Komenti i Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin**, e është reflektuar plotësisht në draft VKM.
3. **Komentet e para dhe të dyta të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës**, sqarojmë se janë reflektuar në projektvendim.

Lidhur me komentin e tretë ju informojmë se për shkak të natyrës së ndryshme, kapacitetit të ndryshëm që kanë impiantet është e pamundur që të përcaktohet me një formulë unike modeli i llogaritjes së kostos dhe tarifës së trajtimit të mbetjeve në impiante të ndryshme. Në rastin e ndërtimit të këtyre lloj impianteve, përlllogaritja e tyre do të jetë pjesë e studimit që do të kryhet për ndërtimin e impiantit në bashki të ndryshme.

4. Lidhur me komentet e të **Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore**, jemi dakort me pikën e parë dhe është reflektuar. Lidhur me komentin e pikës së dytë japim sqarim si më poshtë:

Sic e kemi theksuar në të gjithë relacionin shoqërues ky projektakt nuk synon dhe nuk cënon lirinë e bashkive për përcaktimin e tarifës si vlerë nominale apo shpërndarjen e saj në kategori të ndryshme. Modeli dhe metoda e përcaktimit të tarifës është ndërtuar në frymën e koncepteve të ligjit organik 139/2015 “Për vetë-qeverisjen vendore”, i cili njeh parimet e përbalueshmërisë dhe transparencës për gjeneruesit. Akti përcakton metodën e llogaritjes duke i dhënë mundësinë bashkisë të zgjedhë vetë

elementët përbërës të tarifës dhe më pas të përcaktojë tarifën për secilën kategori dhe më tej për familje. Modeli progresiv ka lirinë të jetë i thjeshtë (forma si operojnë sot bashkitë me tarifë fikse dhe të njëjtë për të gjithë) dhe njëkohësisht i detajuar duke i diferencuar “klientët” sipas parimit “ndotësi paguan”. Ai shkon më tej duke mundësuar mbrojtje për shtresat në nevojë dhe mundëson incentiva të përbalueshme për gjeneruesit e përgjegjshëm të mbetjeve. Ky model dhe metodë orientuese nuk kufizojnë në asnjë rast tagrin që ka Njësia e Vetqeverisjes vendore për vendosjen e e tarifës përkatëse.

Lidhur me komentet e paraqitura pikë për pikë nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, japim më poshtë sqarimet:

**Pika 1:** Shprehemi dakort dhe në draftin e paraqitur janë bërë ndryshimet përkatëse.

**Pika 2:** Shprehemi dakort dhe ndryshimet janë reflektuar në aktin e ndryshuar.

**Pika 3:** Pesha e paraqitur është normë e përcaktuar nga analizat dhe përvoja e mbledhur ne vite. Kjo shifër do të mbetet e pandryshuar në akt dhe ka si qëllim të rrisë eficensën e përdorimit të aseteve.

**Pika 4:** Kostot e shërbimit janë të njëjta në çdo rast. Në rast të një shërbimi të ofruar me PPP ose koncension, janë rregullat e ligjeve përkatëse, të cilat i njohin operatorit privat normat e fitimit. Në të gjitha rastet vlera e aseteve dhe fuqisë punëtore përcaktohen sipas të njëjtit rregull për analizën e vlerave.

**Pika 5:** Bashkitë kanë mundësinë t’i ndryshojnë këto vlera dhe në project-akt janë reflektuar këto komente.

**Pika 6:** Pastrimi nuk do të përfshihet në këtë akt. Pastrimi i rrugëve si dhe larja, gjelbërimi, varrezat, kuartallat e të tjera shërbime nuk janë pjesë e parimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

**Pika 7:** Mënyra e llogaritjes së kosotos nuk pengon nevojën apo interesin e bashkisë për t’i grupuar apo shpërndarë gjeneruesit në familje apo grupe të tjera.

**Pika 8:** Analiza dhe përqsja e sjellë në këtë akt, është nxjerrë nga përvoja shumëvjeçare e punës me sektorin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri dhe vende të tjera (si p.sh. në Zvicër tarifa vendoset për volum të banesës). Ndaj bashkitë janë të lira t’i përdorin indikatorët përbërës të tarifës (si psh. sipërfaqen) sipas një vendimi të marrë në liri të plotë prej stafit dhe këshillit bashkiak. Në rast se nuk kanë kapacitete për të analizuar tarifën në formë

progresive, ashtu siç jemi shprehur dhe më lart, ato mund të përdorin fleksibilitetin e këtij modeli për të vendosur tarifa fikse.

**Komenti në vazhdim:** Komenti i paraqitur është në linjë me parimet e aktit për tarifatat, i cili ka si qëllim të ndryshojë mënyrën e vendosjes së tarifave aktualisht, të cilat bazohen kryesisht në të ardhurat e biznesit pa marrë në konsideratë aktivitetin e tij dhe ndotjen që shkakton. Si p.sh. nëse një zyrë avokatie ka më shumë të ardhura se një dyqan ushqimor me pakicë, ndotja nuk është proporcionale me të ardhurat, por më formën e ushtrimit të aktivitetit. Për këtë arsye bizneset ndër të tjera kategorizohen sipas aktivitetit që ushtrojnë.

**Komenti në vazhdim:** Në pamundësi të një sistemi të peshimit të mbetjeve për secilin klient, akti i propozuar synon të vendosë rregulla më të sakta të përmbushjes së parimit “ndotësi paguan”. Distanca është paraqitur si masë shtrënguese për familje me të ardhura të larta, të cilat zgjedhin të jetojnë në një distancë shumë të largët nga qendra, por që kërkojnë shërbime bashkiake, të cilat në këtë rast do të kushtonin shumë për gjeneruesit e tjerë. Gjithësesi, distanca është e llogaritur në vijë ajrore dhe jo akumulative në rrugëtim nga stacioni ku niset makina dhe në një distancë, e cila në kontekstin urban/rural në Shqipëri nuk ndodh (pra nuk ka shtëpi të cilat ndodhen 10km nga nisja e makinës në vijë ajrore).

**Komenti në vazhdim:** Akti është konsultuar vazhdimisht nga programi për zhvillim lokal dhe decentralizim (dlp) në 5 vitet e fundit dhe ka marrë dakortësi të gjerë nga Bashkitë, aktorë të tjera të interesuar dhe specialistë.

**5. Lidhur me sugjerimet e Ministrisë së Zhvillimit Urban, sqarojmë si vijon:**

Në lidhje me komentin e parë, është reflektuar, duke njehsuar në të dyja shtojcat, plotësimin e numrit të popullsisë referuar Regjistrin të Gjendjes Civile.

Në lidhje me komentin e dytë, për përcaktimin e një shembulli orientues, sqarojmë se gjatë konsultimit të projektvendimit me grupet e interesit, krahas përfaqësuesve të bashkive, janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme për mënyrën e implementimit të metodologjisë dhe skemave. Gjithashtu, pas miratimit do të organizohen një set trajnimesh nëpër 61 bashkitë.

Në lidhje me komentin e tretë fjala “në teori” është hequr.

Komenti i katër “subvencion” është hequr.

Sa i takon komentit të fundit, sqarojmë se sugjerimi i MZHU do të mbahet parasysh gjatë fazës së trajnimeve, të cilat do të zhvillohen pas miratimit të këtij projektvendimi.

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projektvendim nuk përcakton shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë aktualisht të ngritura dhe funksionale.